



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nënparagrafi nën d) dhe nenit 17 paragrafi 1 nën b) dhe r) të Ligjit të Vetëqeverisjes lokale Nr.03/L-040, nënit 15 dhe 20 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.04/L-174, nenit 6 paragrafi 1 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.04/L-144, të nenit 12 dhe 20 të Rregullores QRK, Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës (sipas kërkesave të Bashkësive fetare për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë prej 99 viteve), duke u mbështetur në Vendimin e KK-Klinë për miratim të Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021 me 01 Nr.06-5371/2015 të dt.25.09.2015, Vendimit për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të dt.30.04.2010, me 01Nr.350-1539/10, nenit 10 paragrafi 1 nën pikën 4) të Statutit të Komunës së Klinës, Pëlqimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr.1928/3 të dt.22.07.2015 për ndërrim të destinimit të pronës, shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës, Nr.04-3606 të dt.09.08.2015, Procesverbalin e Debatit me Publikun të dt.19.10.2015, si dhe rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.19.10.2015, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX-të të rregullt për vitin 2015, të mbajtur më 30.10.2015, mori këtë:

V E N D I M P Ë R

NDRYSHIMËT DHE PLOTËSIMËT E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL –PZHK 2014-2021

I

MiratoheN Ndryshimet dhe Plotësimet e Planit Zhvillimor Komunal –PZHK për periudhën 2014-2021, me nevojën për inkorporim në PZHK të dy parcelave, në ZK Këpuz, parcela, Nnr.279-1 tokë bujqësore për ridestinin në tokë ndërtimore pronë e KK Klinë dhe ZK Deiq, parcela Nr.100-2 pronë shoqërore rrugë në Komunën e Klinës, për ridestinin në tokë ndërtimore.

II

Plani Zhvillimor Komunal për periudhën 2014-2021 ndryshon me ridestinimin e dy parcelave në tokë ndërtimore për ndërtim të Xhamisë në Këpuz dhe Kishës Katolike në Deiq.

III

Për inkorporimin e këtyre ndryshimeve dhe ndërmarrjen e hapave të mëtejme kompetentë janë: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me Kompanin projektuese Urban Plus në Prishtinë si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim pronëso-ro-juridik.

IV

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

1. Vendimi pwr Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.350-1539/10 tw dt.30.04.2010
2. Vendimi i KK Klinë për miratim të PZHK 2014-2021 (i rishqyrtuar me 25.09.2015)
3. Vendimi për Rishqyrtimin-suspendimin e ekzekutimit të Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 viteve të pronës së paluajtshme të Komunës, për Bashkësinë Islame me seli në Klinë dhe Administratës Apostolike të Prizrenit me seli në Prishtinë, për nevoja të famullisë “Zoja e Këshillit të Mirë” në Klinë- (vendim ky që kërkohet nga MAPL për rishqyrtim të vendimit të KK të miratuar me 27.03.2015 , për t’iu përmbajtur nenit 6 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, Nr.04/L-144),
4. Pëlqimi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

5. Shkresës nga Ministria e Infrastrukturës,
6. Shkresës nga Kompania Urban Plus në Prishtinë,
7. Dy kopjet e Planit dhe dy certifikatat e pronësisë për ZK Këpuz dhe ZK Deiq,
8. Procesverbali i debatit me Publikun i dt.19.10.2015 dhe,
9. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.19.10.2021.

V

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL-konform nenit 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

VI

Më këtë Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe MM dhe Drejtoria për Kadastër , Gjeodezi dhe Pronësi , Zyra Ligjore, Zyra për Informim, një kopje Dosje dhe një Arkivit të Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-5672/ 2015
Data, më 30.10.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi